



Republika e Kosovës
Republika Kosova – Republic of Kosovo
ORGANI SHQYRTUES I PROKURIMIT
TELO ZA RAZMATRANJE NABAVKE
PROCUREMENT REVIEW BODY



Organi Shqyrtues i Prokurimit (OSHP) – Rruga Migjeni (ish Banka e Ljublanës), Kati V-të, Prishtinë, Kosovë
Tel: 383 38 312 309 email: oshp@rks-gov.net

RAPORTI I EKSPERTIT SHQYRTUES

Eksperti Shqyrtues	Data e pranimit të ekspertit	Date e dorëzimit të raportit	Nr. i lëndës
Kushtrim Myftari	03.04.2026	14.04.2026	2026/0199

BAZA LIGJORE E SHQYRTIMIT

Me datën: 01.04.2026, OE “Inspired Tech SH.P.K.”- Prishtinë, ka parashtruar ankesë me nr: 2026/0199, kundër anulimit të aktivitetit të prokurimit, lidhur me aktivitetin e prokurimit: “Mirembajta e platformes elektronike per monitorimin e reformes ne Administrate Publike” me nr. të prokurimit: "214-25-7856-2-2-1", iniciuar nga Autoriteti Kontraktues (AK) – MINISTRIA E PUNËVE TË BRENDSHME.

Autoriteti kontraktues ka zbatuar: **Procedurë të hapur,**

Lloji i kontratës: Shërbim,

Vlera e parashikuar e kontratës: 80,000.00 €

Nëse është e përsëritur ankesa, të shënohet se lidhur me këtë lëndë është nxjerr një vendim i mëparshëm i OSHP - së, më **Nr 2026/0004**

Konform nenit 113, 114 të Ligjit Nr. 04 / L - 042, i plotësuar dhe ndryshuar me Ligjin 04 / L - 237, Ligjin 05 / L - 068, dhe Ligjin 05 / L - 092, Eksperti Shqyrtues i ka shqyrtuar pretendimet ankimore të OE ankues.

DISPOZITAT E SHKELURA DHE PRETENDIMET ANKIMORE

--

është refuzuar si e pabazuar.

Kërkesa jonë për rishqyrtim, drejtuar Autoritetit Kontraktues më datë 25.03.2025, është refuzuar si e pabazuar.

7. Dispozitat e shkelura nga Autoriteti Kontraktues

Specifikoni dispozitën ose dispozitat e LPP-së që supozohet të jenë shkelur nga Autoriteti Kontraktues që nga momenti i publikimit të Njoftimit për Kontratë/Konkurs të Projektimit, dhe nëse aplikohet gjerë në përmbylljen e këtij aktiviteti të prokurimit me publikimin e Njoftimit për Dhënie të Kontratës apo Njoftimit për Rezultatet e Konkursit të Projektimit apo Njoftimit për Anulim.

Neni 6 – Ekonomiciteti dhe Efikasiteti

Neni 7 i LPP – Barazia në Trajtim / Jo-Diskriminimi

Neni 59 – Ekzaminimi, Vlerësimi dhe Krahësimi i Tenderëve

Neni 69 – Aftësia Teknike dhe/ose Profesionale

Neni 40.2. Rregullores së Prokurimit Publik,

*** Sipas Nenit 118 të LPP, OSHP-ja do të kthejë tarifën tuaj nëse ankesa aprovohet si e bazuar. OSHP-ja mund të kërkojë një gjabë shtesë deri në 5,000 Euro në rastet kur OSHP-ja konstaton që të gjitha apo cilado nga pretendimet e parashtruara në ankesë kanë qenë të rrejshme ose mashtruese.*

8. Deklaratë detale mbi faktet dhe argumentet

Përshkruani rrethanat faktike që përbëjnë supozimin për shkeljen e dispozitave të LPP-së. Ofroni deklaratë të qartë dhe të detajuar për faktet dhe argumentet të cilat mbështesin secilën bazë të ankesës tuaj.

Ne OE ofertues në aktivitetin e prokurimit 214-25-7856-2-2-1 dhe si palë me interes, brenda afatit ligjor paraqsim këtë ankesë pranë OSHP-së, kundër vendimit të Autoritetit Kontraktues të datës 19.03.2026 për anulimin e aktivitetit të prokurimit si dhe kundër vendimit për refuzimin e kërkesës për rishqyrtim, duke konsideruar se të njëjtat janë marrë në kundërshtim me dispozitat ligjore në fuqi, parimet themelore të prokurimit publik.

Nga kronologjia e ecurisë së aktivitetit të prokurimit rezulton qartë se Autoriteti Kontraktues ka vepruar në kundërshtim flagrant me dispozitat ligjore, duke na eliminuar si ofertues të përgjegjshëm, ndonëse kemi qenë ofertues i përgjegjshëm dhe me ofertën më të favorshme ekonomike. Ky konstatim nuk është vetëm pretendim i palës sonë, por është vërtetuar në mënyrë eksplicite edhe nga Organi Shqyrtues i Prokurimit përmes vendimit me nr. protokolli 04/26, me të cilin është konstatuar se eliminimi ynë ka qenë i pabazuar dhe është urdhëruar kthimi i lëndës në rivlerësim. Si rrjedhojë, mosshpallja jonë si fitues në fazën e parë të vlerësimit nuk është rezultat i ndonjë mangësie të ofertës sonë, por pasojë e drejtpërdrejtë e veprimeve të kundërligjshme të Autoritetit Kontraktues, të cilat kanë prodhuar zvarritje të panevojshme dhe të pajustificueshme të procedurës. Kjo zvarritje evidentohet qartë nga fakti se Autoritetit Kontraktues i janë nevojitur rreth 88 ditë për të përfunduar vlerësimin e ofertave, përkatësisht nga data e hapjes së ofertave më

18.09.2025 deri në publikimin e njoftimit për dhënie të kontratës (formulari B58) më 15.12.2025, duke tejkaluar në mënyrë të qartë dhe të pajustificuar afatet ligjore të përcaktuara me rregullativën në fuqi.

Përkundër obligimit për të vepruar me urgjencë dhe në përputhje me vendimin e OSHP-së, Autoriteti Kontraktues është vonuar realizimin e rivlerësimit për rreth 40 ditë nga data e marrjes së vendimit (12.02.2026), pa ndonjë arsye të arsyeshme dhe pa ndonjë kompleksitet që do ta justifikonte një zvarritje të tillë.

Këto veprime dëshmojnë për një menaxhim joefikas dhe jo në përputhje me kërkesat ligjore të procedurës së prokurimit, duke krijuar rrethana të cilat më pas janë përdorur si arsyetim për anulimin e procedurës.

Vendimi për anulimin e procedurës është arsyetuar me pretendimin për mungesë të mjeteve buxhetore si rezultat i riorganizimit institucional. Megjithatë, një arsyetim i tillë nuk gjen mbështetje në nenin 43.5 të Rregullores së Prokurimit Publik, i cili përcakton në mënyrë taksative rastet kur lejohet anulimi i një procedure pas hapjes së ofertave. Në rastin konkret nuk ekziston asnjë nga rrethanat e parapara me këtë dispozitë ligjore, çka nënkupton se vendimi për anulim është marrë pa bazë ligjore dhe në tejkalim të kompetencave të Autoritetit Kontraktues.

Në përputhje me praktikën e konsoliduar të Organit Shqyrtues të Prokurimit, anulimi i një procedure në një fazë të avancuar, pas hapjes dhe vlerësimit të ofertave, lejohet vetëm në rrethana të jashtëzakonshme, të qarta dhe të dokumentuara, të cilat në mënyrë objektive e bëjnë të pamundur vazhdimin e procedurës. Çështjet që lidhen me planifikimin apo menaxhimin buxhetor nuk përbëjnë rrethana të tilla, pasi sigurimi i mjeteve financiare është obligim paraprak dhe ekskluziv i Autoritetit Kontraktues dhe nuk mund të bartet si pasojë negative mbi operatorët ekonomikë.

Në këtë kontekst, rezulton se Autoriteti Kontraktues, pasi fillimisht ka vepruar në mënyrë të kundërligjshme duke na eliminuar nga procedura, tani në mënyrë po ashtu të kundërligjshme ka vendosur për anulimin e aktivitetit të prokurimit, duke krijuar një situatë ku shkeljet e mëparshme tentohen të maskohen përmes një vendimi të ri, i cili në thelb cenon rëndë parimet e barazisë, transparencës dhe trajtimit të drejtë.

Sa i përket pretendimit për riorganizim institucional dhe bartje të buxhetit në një institucion tjetër, theksojmë se një zhvillim i tillë nuk përbën rrethanë të paparashikueshme në kuptim juridik dhe nuk mund të shërbejë si bazë për anulimin e një procedure të prokurimit që ndodhet në fazë të avancuar. Për më tepër, në praktikën administrative dhe financiare, obligimet kontraktuale, procedurat dhe kontratat aktivie transferohen tek institucionet pasardhëse së bashku me burimet përkatëse buxhetore. Në rastin konkret, duke qenë se procedura ka qenë në fazë të rivlerësimit dhe se ekziston një ofertues i përgjegjshëm me çmimin më të ulët, Autoriteti Kontraktues ka pasur mundësi reale dhe obligim ligjor që këtë aktivitet ta koordinojë dhe ta bartë tek institucioni pasardhës, në vend që ta anulojë atë në mënyrë të njëanshme.

Veprimi për anulim, në këto rrethana, paraqet një përdorim të gabuar dhe të tejkaluar të

diskrecionit administrativ, i cili bie ndesh me qëllimin dhe frymën e legjislacionit të prokurimit publik. Për më tepër, fakti që aktivitete të tjera të ngjashme vazhdojnë të planifikohen dhe realizohen, ndërsa vetëm kjo procedurë anulohet, përforcon dyshimet e arsyeshme për një qasje selektive dhe për shmangie të dhënies së kontratës operatorit ekonomik me ofertën më të favorshme.

Në këto rrethana, bëhet e qartë se anulimi i procedurës nuk është rezultat i një situatë objektive dhe të pashmangshme, por rrjedhë e drejtpërdrejtë e veprimeve dhe mosveprimeve të Autoritetit Kontraktues, përfshirë eliminimin e kundërligjshëm në fazën fillestare, vonesat e pajustificueshme në rivlerësim dhe keqmenaxhimin e çështjeve buxhetore dhe organizative. Veprime të tilla, përveç që cenojnë të drejtat e operatorëve ekonomikë, mund të implikojnë edhe përgjegjësi ligjore për zyrtarët përgjegjës.

Për më tepër, në vlerësimin e këtij rasti duhet të merren parasysh edhe disa fakte thelbësore që e bëjnë të paqëndrueshëm arsyetimin e Autoritetit Kontraktues.

- Së pari, autoriteti i ri kontraktues, në të cilin pretendohet se është bartur buxheti, ende nuk është krijuar dhe nuk është funksional, madje nuk ka as siguri nëse dhe kur do të operacionalizohet. Në këto rrethana, anulimi i një procedure ekzistuese mbi bazën e një strukture ende hipotetike paraqet veprim të nxituar dhe juridikisht të pambështetur.
- Së dyti, Ligji për Ndarjet Buxhetore për vitin 2026, i miratuar në muajin shkurt, nuk e parashih fare këtë institucion si njësi buxhetore dhe nuk alokon mjete për të, çka dëshmon se pretendimi për bartje të buxhetit nuk ka bazë reale dhe mbetet i pasigurt deri në një rishikim të mundshëm buxhetor.
- Së treti, mosfinalizimi i këtij aktiviteti përmes lidhjes së kontratës do të ketë pasoja të drejtpërdrejta në mosrealizimin e shërbimit për të paktën edhe një vit, duke cenuar jo vetëm interesin e operatorëve ekonomikë, por edhe interesin publik dhe funksionimin normal të shërbimeve që vetë Autoriteti Kontraktues i ka konsideruar të nevojshme.

Duke u bazuar në të gjitha faktet dhe argumentet e paraqitura, kërkojmë nga Organi Shqyrtues i Prokurimit që ta aprovojë këtë ankesë si të bazuar, të anulojë vendimin e Autoritetit Kontraktues për anulimin e procedurës, lënda të kthehet në rivlerësim dhe OSHP të detyrojë Autoritetin Kontraktues që të zbatojë vendimin e mëparshëm të OSHP-së duke e kthyer lëndën në rivlerësim.

Njëkohësisht, kërkojmë që gjatë rivlerësimit të ofertave të konstatohet përgjegjshmëria e ofertës sonë dhe të shpallemi fitues të këtij aktiviteti të prokurimit, duke qenë se oferta jonë i plotëson të gjitha kërkesat e dosjes së tenderit dhe përfaqëson ofertën me çmimin më të ulët në përputhje me kriterin e dhënies së kontratës.

KRITERET PËR VLERËSIM

Nëse po, përshkrimi i kushteve të veçanta

III.2) KUSHTET PËR PJESËMARRJE

III.2.1) Kërkesat e përshtatshmërisë:

a. Operatori ekonomik duhet ti përmbush kërkesat mbi përshtatshmërinë në pajtim me Nenin 65 të Ligjit Nr. 04 L-042 për Prokurimin Publik të Republikës së Kosovës, i ndryshuar dhe plotësuar me ligjin Nr. 04 L-237, ligjin Nr. 05 L-068 dhe ligjin Nr. 05 L-092.

b. Një dokument nga Administrata Tatimore e vendit tuaj të themelimit, se ju nuk jeni me vonesë për pagimin e tatimeve së paku në tremujorin e fundit para datës së publikimit të Njoftimit për kontratë.

c. Një dokument i lëshuar nga Gjykata kompetente që vërteton se operatori ekonomik i përmbush “Kërkesat e përshtatshmërisë”- të jetë i lëshuar së paku në tremujorin e fundit para datës së publikimit të Njoftimit për kontratë.

d. Një dokument i lëshuar nga Gjykata kompetente apo autoritetet administrative të vendit të themelimit të tenderuesit, që vërteton se tenderuesi i përmbush “Kërkesat e pranueshmërisë”, se drejtuesit, menaxheret e saj gjatë dhjetë viteve të kaluara nuk janë shpallur fajtor nga një gjykatë kompetente për kryerjen e një vepre penale ose civile, i cili dokument duhet të jetë jo më i vjetër se 3 muaj para datës së publikimit të Njoftimit për kontratë.

Dëshmia e kërkuar dokumentare:

a. Një deklaratë e shkruar nën Betim, e nënshkruar nga tenderuesi duke përdorur formën e përcaktuar në dosjen

b. Vërtetimin nga Administrata Tatimore (kopje), duhet të dorëzohen vetëm nga tenderuesi fitues, para publikimit të dhënies së kontratës. Dështimi i Operatorit Ekonomik që është propozuar që të shpërblehet me kontratë të sjellë dokumentin e kërkuar i jep të drejtë Autoritetit Kontraktues që ofertën ta refuzoj, ta beje konfiskimin e garancionit për sigurim të ofertës dhe të vazhdojë me shpërbllim të kontratës me Operatorin Ekonomik që është rendit në vendin e dytë e kështu me radhë.

c. Vërtetimin nga Gjykata Themelore-Departamenti për Çështje Ekonomike apo autoritetet administrative të vendit të themelimit të operatorit ekonomik (kërkohet origjinal ose i vërtetuar noterizuar nga institucioni kompetent në vendin tuaj të themelimit), duhet të dorëzohen vetëm nga tenderuesi fitues, para publikimit të dhënies së kontratës. Dështimi i Operatorit Ekonomik që është propozuar që të shpërblehet me kontratë të sjellë dokumentin e kërkuar i jep të drejtë Autoritetit Kontraktues që ofertën ta refuzoj, ta beje konfiskimin e garancionit për sigurim të ofertës dhe të vazhdojë me shpërbllim të kontratës me Operatorin Ekonomik që është rendit në vendin e dytë e kështu me radhë.

d. Vërtetimin nga Gjykata kompetente apo autoritetet administrativ (kërkohet origjinal ose i vërtetuar noterizuar nga institucioni kompetent në vendin tuaj të themelimit), duhet të dorëzohen vetëm nga tenderuesi fitues, para publikimit të dhënies së kontratës. Dështimi në dorëzim të Çertifikatës nga Gjykata përkatëse, tenderi i tij do të refuzohet si dhe do të konfiskohet siguri i tenderit nëse e njëjta është kërkuar, AK do të iniciojë procedurën për diskualifikim në përputhje me nenin 99.2 të LPP-se dhe të vazhdojë me shpërbllim të kontratës me Tenderuesin që është listuar në vendin e dytë.

III.2.2) Përshtatshmëria profesionale:

Dëshmia e kërkuar dokumentare:

B05 Njoftim per Kontrat

4 / 8

a. Certifikatë e regjistrimit të biznesit, regjistrimit si operator ekonomik në regjistrin profesional, komercial dhe ose të korporatës në vendin tuaj të themelimit me Informata mbi biznesin dhe veprimtaritë. Për Operatorin Ekonomik jo rezident në Kosovë, nëse shpërblehet me kontratë, para nënshkrimit të kontratës, është i obliguar që ta regjistrojë përfaqësinë e biznesit në Republikën e Kosovës.	a. Certifikatë e regjistrimit të biznesit (kopje).
b. Deklarues i TVSH-së, (për kompanitë vendore).	b. Certifikata e TVSH-së (kopje).
III.2.3) Kapaciteti ekonomik dhe financiar: a. Operatori ekonomik ose grup i OE pjesëmarrës, duhet të ofrojë dëshmi të kënaqshme Autoritetit kontraktues, së qarkullimi vjetor (të hyrat) e OE gjatë tri viteve (2022, 2023, 2024) kanë qenë jo më pak se 160,000.00€. Në rast të pjesëmarrjes si Grup i OE-vë, Lideri i grupit duhet të përmbushë së paku 60% të këtijë qarkullimi minimal.	<i>Dëshmia e kërkuar dokumentare:</i> a. Kopjet e Deklaratave Tatimore Vjetore të dorëzuara në Administratën Tatimore të Kosovës ose nga vendi i origjinës.
III.2.4) Kapaciteti teknik dhe profesional: 1. Operatori ekonomik duhet të ketë kontrata të ngjajshme të realizuar në tri vitet e fundit nga data e njoftimit për kontratë në vlerë prej 120,000.00 euro së paku një projekt të ngjashëm të përfunduar dhe implementuar për zhvillimin e një platforme të ngjajshme online në C#, Microsoft .Net, Angular, SQL Server, Angular Material UI, Nebular Angular UI, etj. 2. Operatori Ekonomik duhet të jetë i certifikuar në minimum këto ISO Standardet si - ISO 27001 - për menaxhimin e sigurisë së të dhënave - ISO 9001 - për menaxhimin e cilësisë - Certificate valide për menaxhimin e integruar të sistemeve. 3. Projekt Menagjer - Diplomë Universitare në Shkenca Kompjuterike, dhe ose Inxhinieri kompjuterike Minimumi 5 vite përvojë pune dhe menaxhim i të paktën një projekti të ngjashëm në platformat Microsoft (.NET, SQL Server dhe Angular), dhe ekuivalente. 4. Ekspert këshillues për politikë - Diplomë Universitare në fushën e Administratës Publike, Shkencave Politike, Marrëdhënie ndërkombëtare. Minimumi 5 vite përvojë pune në dhe me Administratë publike dhe marrëdhënie ndërkombëtare, dhe ekuivalente. 5. Arkitekt zhvillues i Softuerit Senior - Diplomë Universitare në Shkenca Kompjuterike, dhe ose Inxhinieri kompjuterike Certifikuar në Microsoft .Net. dhe ekuivalente. Minimum 5 vite përvojë si arkitekt zhvillues softueri, dhe referencë për pjesëmarrje në minimum një	<i>Dëshmia e kërkuar dokumentare:</i> Lista e projekteve të përfunduara, e vëlosur dhe e nënshkruar nga OE, duke paraqitur edhe vlerën, datën dhe vendin e realizimit të projektit. Dëshmia Referenca nga klienti ose procesverbalet e pranimit përfundimtar të shërbimeve nga klienti. Kopjet e ISO certifikatave – valide. -Diplomë, CV, Certifikata përkatëse -Kontratë ose marrëveshje pune. Vendim për caktimin e Projekt Menagjer. -Referenca për të dëshmuar përvojën e punës. -Diplomë, CV, Certifikata përkatëse -Kontratë ose marrëveshje pune. -Referenca për të dëshmuar përvojën e punës. -Diplomë, CV, Certifikata përkatëse -Kontratë ose marrëveshje pune. -Referenca për të dëshmuar përvojën e punës.

projekt të ngjashëm. 6. Zhvillues i bazës së të dhënave Senior - Diplomë Universitare në Shkenca Kompjuterike, dhe ose Inxhinieri kompjuterike. Certifikatuar në Microsoft për Implementimin e Microsoft SQL Server, dhe ekuivalente. Minimum 5 vite përvojë në zhvillimin e bazave të të dhënave në SQL Server dhe pjesëmarrje në të paktën një projekt të zhvillimit të bazave të të dhënave.	-Diplomë, CV, Certifikata përkatëse -Kontratë ose marrëveshje pune. -Referenca për të dëshmuar përvojën e punës.
--	---

III.3) KUSHTET SPECIFIKE PËR KONTRATAT E SHËRBIMEVE

Po ☐ Jo ☒

III.3.1)Ekzekutimi i shërbimeve i rezervuar për një profesion të caktuar

Nëse po, referenca për ligjin, rregulloren apo dispozitën administrative përkatëse

III.3.2 Personat ligjor duhet të tregojnë emrat e kualifikimeve profesionale të personelit përgjegjës për ekzekutimin e shërbimeve

Po ☐ Jo ☒

NENI IV: PROCEDURA

IV.1) LLOJI I PROCEDURËS

IV.1.1) Lloji i procedurës

☒ E hapur

☐ E kufizuar

☐ Konkurruese me negociata

☐ Kuotim i Çmimit

IV.1.2)Kufizime në numrin e operatorëve të cilët do të ftohen për tenderim (procedurë e kufizuar apo konkurruese me negociata)

Në bazë të aplikacioneve të pranuar, më së shumti 6 kandidat do të ftohen për të dorëzuar tenderët e detajuar të kësaj kontrate. Nëse më shumë se 6 kandidat të përshtatshëm i plotësojnë kriteret e mësipërme të përzgjedhjes, përparësitë dhe dobësitë relevante të aplikacioneve të këtyre kandidatëve do të ri-ekzaminohen për të identifikuar gjashtë aplikacionet më të mira për procedurën e tenderit. Të vetmit faktorë të cilët do të mirren parasysh gjatë këtij ri-ekzaminimi janë:

IV.1.3) Reduktimi i numrit të operatorëve gjatë negociatave (procedurë konkurruese me negociata)

Udhëheq negociatat në faza të njëpasnjëshme

Po ☐ Jo ☐

në mënyrë që të zvogëlohet numri i tenderëve të negociuar

Autoritetet kontraktuese mund të shpërblejnë kontratat në bazë të tenderëve fillestarë pa negociata

Po ☐ Jo ☐

IV.1.4 Numri minimal i kandidateve të cilët do të ftohen që të dorëzojnë Tenderët fillestar është:

IV.1.5. Informata në lidhje me ankandin elektronik

RAPORTI I KOMISIONI VLERËSUES

IDENTIFIKIMI I TENDERUESVE TË REKOMANDUAR PËR DHËNIE TË KONTRATËS			
Nr:	Grupi:		
1	Mirëmbajta e platformës elektronike për monitorimin e reformës në Administratë Publike		
	Emri i tenderuesit të suksesshëm	Kodi postar	Adresa
	NOVUS SH.P.K., 600834065	10000	Rr.Tirana nr.31, kati 6

☐

DEKLARATË

[të deklarohet komisioni vlerësues mbi arsyet që e mbështesin këtë rekomandim]

Komisioni i vlerësimit krahasimit dhe ekzaminimit të ofertave, për tenderin me Titull: “Mirëmbajta e platformës elektronike për monitorimin e reformës në Administratë Publike”, pas shqyrtimit të tërësishëm të dokumentacionit të dorëzuar nga tenderuesit për këtë AP, komisioni konstaton se janë pranuar tri oferta dhe pas analizimit të dokumentacionit kemi vetëm një ofertë të përgjegjshme.

Duke i bazuar në kriterin e dhënies së kontratës e që është tenderi i përgjegjshëm më të lirë, rekomandojnë zyrtarit përgjegjës të prokurimit, që me këtë kontratë të shpërblehet tenderi i përgjegjshëm me çmimin më të ulët të tenderuesit “NOVUS” SH.P.K. Rr. Tirana nr.31, kati 6, 10000, Prishtinë, në vlerë totale të ofertës prej 69,948.00€

pro (Former)



Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada-Government

Ministria e Puneve te Brendshme-Ministarstvo Unutrasnjih Poslova-Ministry of Internal Affairs

B58 - NJOFTIM MBI VENDIMIN E AUTORITETIT KONTRAKTUES¹

Sipas Nenit 43.7 dhe 44.2 të Rregullave dhe Udhëzuesit Operativ të Prokurimit Publik

Titulli i kontratës: “Mirëmbajta e platformës elektronike për monitorimin e reformës në Administratë Publike”

Nr. i Prokurimit ²	214-25-7856-2-2-1
-------------------------------	-------------------

Nr.	Emri dhe adresa e Operatorit Ekonomik	Vlera e ofertës çmimi për njësi dhe me peshim €
1.	Inspired Tech SH.P.K., Bardhyl Çausi, Ob C15/10, Nr. 3, 10000, Prishtinë	39,996.00€
2.	NOVUS SH.P.K., Rr.Tirana nr.31, kati 6, 10000, Prishtinë	69,948.00€
3.	CMD SH.P.K., Prishtinë, N. Terezhë 40a Nr. 2, 10000, Prishtinë	44,100.00€

Rezultati i aktivitetit të prokurimit:

Ministria e Punëve të Brendshme **anulon** aktivitetin e prokurimit: “Mirëmbajta e platformës elektronike për monitorimin e reformës në Administratë Publike”

☒ *Një dispozitë në Ligjin e Prokurimit Publik kërkon anulimin e aktivitetit të prokurimit.*

ARSYETIM PËR ANULIMIN E PROCEDURËS SË PROKURIMIT

Autoriteti Kontraktues kishte iniciuar procedurën e prokurimit me titull: Mirëmbajta e platformës elektronike për monitorimin e reformës në Administratë Publike”, me numër të prokurimit: 214-25-7856-2-2-1.

¹ Këtij formulari i bashkangjiten edhe letrat standarde të njoftimeve: B42, B45 dhe B46.(shtoni letra njoftuese sipas nevojës).

Të raportohet në çdo dokument apo kërkesë në lidhje me këtë aktivitet të prokurimit.

Pas inicimit të kësaj procedure, me vendim të Qeverisë së Republikës së Kosovës me numër 02/02 të datës 20.02.2026 për riorganizimin institucional, është bërë ndarja e ministrisë, ku si rezultat janë krijuar struktura të reja institucionale. Si pasojë e këtij riorganizimi institucional është bërë edhe ndarja e buxhetit përkatës ndërmjet institucioneve të reja.


Për shkak të këtij ndryshimi, Autoriteti Kontraktues aktualisht nuk disponon mjetet e nevojshme buxhetore për realizimin e kësaj procedure të prokurimit, pasi buxheti i planifikuar për këtë aktivitet është ndarë sipas strukturës së re institucionale.

Duke u bazuar në këto rrethana dhe në pamundësinë për të siguruar financimin e kontratës, Autoriteti Kontraktues anulon procedurën e prokurimit, për shkak të mungesës së mjeteve buxhetore të nevojshme për realizimin e saj.

Ky anulim bëhet në përputhje me dispozitat përkatëse të Ligjit për Prokurimin Publik, që lejojnë anulimin e procedurës në rastet kur Autoriteti Kontraktues nuk ka më mjete të mjaftueshme buxhetore për realizimin e kontratës.

Data: 19/03/2026

Emri dhe mbiemri i ZPP: Agim ISLAMI



INFORMACIONET SHITESË TË MARRA ME ANË TË SQARIME TË KËRKUARA NGA EKSPERTI SHQYRTUES/TEKNIK

VLERËSIMI SIPAS NENIT 4.1.26 TË LPP

VENDIMET E MËPARSHME TË OSHP LIDHUR ME RASTET E NGJASHME

ARSYETIMI PËR DEVIJIM NGA PRAKTIKA E MËPARSHME

PËRGJIGJE NË PRETENDIMET ANKIMORE TË OE ANKUES - **Inspired Tech SH.P.K.**

Përmbledhje e pretendimeve ankimore të Operatorit ekonomik ankues:

Ne OE ofertues në aktivitetin e prokurimit 214-25-7856-2-2-1 dhe si palë me interes, brenda afatit ligjor paraqsim këtë ankesë pranë OSHP-së, kundër vendimit të Autoritetit Kontraktues të datës 19.03.2026 për anulimin e aktivitetit të prokurimit si dhe kundër vendimit për refuzimin e kërkesës për rishqyrtim, duke konsideruar se të njëjtat janë marrë në kundërshtim me dispozitat ligjore në fuqi, parimet themelore të prokurimit publik.

Nga kronologjia e ecursë së aktivitetit të prokurimit rezulton qartë se Autoriteti Kontraktues ka vepruar në kundërshtim flagrant me dispozitat ligjore, duke na eliminuar si ofertues të papërgjegjshëm, ndonëse kemi qenë ofertues i përgjegjshëm dhe me ofertën më të favorshme ekonomike. Ky konstatim nuk është vetëm pretendim i palës sonë, por është vërtetuar në mënyrë eksplicite edhe nga Organi Shqyrtues i Prokurimit përmes vendimit me nr. protokollit 04/26, me të cilin është konstatuar se eliminimi ynë ka qenë i pabazuar dhe është urdhëruar kthimi i lëndës në rivlerësim. Si rrjedhojë, mosshpallja jonë si fitues në fazën e parë të vlerësimit nuk është rezultat i ndonjë mangësie të ofertës sonë, por pasojë e drejtpërdrejtë e veprimeve të kundërligjshme të Autoritetit Kontraktues, të cilat kanë prodhuar zvarritje të panevojshme dhe të pajustificueshme të procedurës. Kjo zvarritje evidentohet qartë nga fakti se Autoritetit Kontraktues i janë nevojitur rreth 88 ditë për të përfunduar vlerësimin e ofertave, përkatësisht nga data e hapjes së ofertave më

18.09.2025 deri në publikimin e njoftimit për dhënie të kontratës (formulari B58) më 15.12.2025, duke tejkaluar në mënyrë të qartë dhe të pajustificuar afatet ligjore të përcaktuara me rregullativën në fuqi.

Përkundër obligimit për të vepruar me urgjencë dhe në përputhje me vendimin e OSHP së, Autoriteti Kontraktues është vonuar realizimin e rivlerësimit për rreth 40 ditë nga data e marrjes së vendimit (12.02.2026), pa ndonjë arsye të arsyeshme dhe pa ndonjë kompleksitet që do ta justifikonte një zvarritje të tillë.

Këto veprime dëshmojnë për një menaxhim joefikas dhe jo në përputhje me kërkesat ligjore të procedurës së prokurimit, duke krijuar rrethana të cilat më pas janë përdorur si arsyetim për anulimin

e procedurës.

Vendimi për anulimin e procedurës është arsyetuar me pretendimin për mungesë të mjeteve buxhetore si rezultat i riorganizimit institucional. Megjithatë, një arsyetim i tillë nuk gjen mbështetje në nenin 43.5 të Rregullores së Prokurimit Publik, i cili përcakton në mënyrë taksative rastet kur lejohet anulimi i një procedure pas hapjes së ofertave. Në rastin konkret nuk ekziston asnjë nga rrethanat e parapara me këtë dispozitë ligjore, çka nënkupton se vendimi për anulim është marrë pa bazë ligjore dhe në tejkalim të kompetencave të Autoritetit Kontraktues.

Në përputhje me praktikën e konsoliduar të Organit Shqyrtues të Prokurimit, anulimi i një procedure në një fazë të avancuar, pas hapjes dhe vlerësimit të ofertave, lejohet vetëm në rrethana të jashtëzakonshme, të qarta dhe të dokumentuara, të cilat në mënyrë objektive e bëjnë të pamundur vazhdimin e procedurës. Çështjet që lidhen me planifikimin apo menaxhimin buxhetor nuk përbëjnë rrethana të tilla, pasi sigurimi i mjeteve financiare është obligim paraprak dhe ekskluziv i Autoritetit Kontraktues dhe nuk mund të bartet si pasojë negative mbi operatorët ekonomikë.

Në këtë kontekst, rezulton se Autoriteti Kontraktues, pasi fillimisht ka vepruar në mënyrë të kundërligjshme duke na eliminuar nga procedura, tani në mënyrë po ashtu të kundërligjshme ka vendosur për anulimin e aktivitetit të prokurimit, duke krijuar një situatë ku shkeljet e mëparshme tentohen të maskohen përmes një vendimi të ri, i cili në thelb cenon rëndë parimet e barazisë, transparencës dhe trajtimit të drejtë.

Sa i përket pretendimit për riorganizim institucional dhe bartje të buxhetit në një institucion tjetër, theksojmë se një zhvillim i tillë nuk përbën rrethanë të paparashikueshme në kuptim juridik dhe nuk mund të shërbejë si bazë për anulimin e një procedure të prokurimit që ndodhet në fazë të avancuar. Për më tepër, në praktikën administrative dhe financiare, obligimet kontraktuale, procedurat dhe kontratat aktive transferohen tek institucionet pasardhëse së bashku me burimet përkatëse buxhetore. Në rastin konkret, duke qenë se procedura ka qenë në fazë të rivlerësimit dhe se ekziston një ofertues i përgjegjshëm me çmimin më të ulët, Autoriteti Kontraktues ka pasur mundësi reale dhe obligim ligjor që këtë aktivitet ta koordinojë dhe ta bartë tek institucioni pasardhës, në vend që ta anulojë atë në mënyrë të njëanshme.

Veprimi për anulim, në këto rrethana, paraqet një përdorim të gabuar dhe të tejkaluar të diskrecionit administrativ, i cili bie ndesh me qëllimin dhe frymën e legjislacionit të prokurimit publik. Për më tepër, fakti që aktivitete të tjera të ngjashme vazhdojnë të planifikohen dhe realizohen, ndërsa vetëm kjo procedurë anulohet, përforcon dyshimet e arsyeshme për një qasje selektive dhe për shmangie të dhënies së kontratës operatorit ekonomik me ofertën më të favorshme.

Në këto rrethana, bëhet e qartë se anulimi i procedurës nuk është rezultat i një suate objektive dhe të pashmangshme, por rrjedhë e drejtpërdrejtë e veprimeve dhe mosveprimeve të Autoritetit Kontraktues, përfshirë eliminimin e kundërligjshëm në fazën fillestare, vonesat e pajustificueshme në rivlerësim dhe keqmenaxhimin e çështjeve buxhetore dhe organizative. Veprime të tilla, përveç që cenojnë të drejtat e operatorëve ekonomikë, mund të implikojnë edhe përgjegjësi ligjore për zyrtarët përgjegjës.

Për më tepër, në vlerësimin e këtij rasti duhet të merren parasysh edhe disa fakte thelbësore që e bëjnë të paqëndrueshëm arsyetimin e Autoritetit Kontraktues.

- Së pari, autoriteti i ri kontraktues, në të cilin pretendohet se është bartur buxheti, ende nuk është

krijuar dhe nuk është funksional, madje nuk ka as siguri nëse dhe kur do të operacionalizohet. Në këto rrethana, anulimi i një procedure ekzistuese mbi bazën e një strukture ende hipotetike paraqet veprim të nxituar dhe juridikisht të pambështetur.

- Së dyti, Ligji për Ndarjet Buxhetore për vitin 2026, i miratuar në muajin shkurt, nuk e parasheh fare këtë institucion si njësi buxhetore dhe nuk alokon mjete për të, çka dëshmon se pretendimi për bartje të buxhetit nuk ka bazë reale dhe mbetet i pasigurt deri në një rishikim të mundshëm buxhetor.

- Së treti, mosfinalizimi i këtij aktiviteti përmes lidhjes së kontratës do të ketë pasoja të drejtpërdrejta në mosrealizimin e shërbimit për të paktën edhe një vit, duke cenuar jo vetëm interesin e operatorëve ekonomikë, por edhe interesin publik dhe funksionimin normal të shërbimeve që vetë Autoriteti Kontraktues i ka konsideruar të nevojshme.

Duke u bazuar në të gjitha faktet dhe argumentet e paraqitura, kërkojmë nga Organi Shqyrtues i Prokurimit që ta aprovojë këtë ankesë si të bazuar, të anulojë vendimin e Autoritetit Kontraktues për anulimin e procedurës, lënda të kthehet në rivlerësim dhe OSHP të detyrojë Autoritetin Kontraktues që të zbatojë vendimin e mëparshëm të OSHP së duke e kthyer lëndën në rivlerësim. Njëkohësisht, kërkojmë që gjatë rivlerësimit të ofertave të konstatohet përgjegjshmëria e ofertës sonë dhe të shpallemi fitues të këtij aktiviteti të prokurimit, duke qenë se oferta jonë i plotëson të gjitha kërkesat e dosjes së tenderit dhe përfaqëson ofertën me çmimin më të ulët në përputhje me kriterin e dhënies së kontratës.

Arsyeja e anulimit të procedurës nga autoriteti kontraktues është:

☒ *Një dispozitë në Ligjin e Prokurimit Publik kërkon anulimin e aktivitetit të prokurimit.*

ARSYETIM PËR ANULIMIN E PROCEDURËS SË PROKURIMIT
Autoriteti Kontraktues kishte iniciuar procedurën e prokurimit me titull: Mirëmbajta e platformës elektronike për monitorimin e reformës në Administratë Publike”, me numër të prokurimit: 214-25-7856-2-2-1.

¹ Këtij formulari i bashkangjiten edhe letrat standarde të njoftimeve: B42, B45 dhe B46.(shtoni letra njoftuese sipas nevojës).

Të raportohet në çdo dokument apo kërkesë në lidhje me këtë aktivitet të prokurimit.
B58 - NJOFTIM MBI VENDIMIN E AUTORITETIT KONTRAKTUES

Pas inicimit të kësaj procedure, me vendim të Qeverisë së Republikës së Kosovës me numër 02/02 të datës 20.02.2026 për riorganizimin institucional, është bërë ndarja e ministrisë, ku si rezultat janë krijuar struktura të reja institucionale. Si pasojë e këtij riorganizimi institucional është bërë edhe ndarja e buxhetit përkatës ndërmjet institucioneve të reja.

Për shkak të këtij ndryshimi, Autoriteti Kontraktues aktualisht nuk disponon mjetet e nevojshme buxhetore për realizimin e kësaj procedure të prokurimit, pasi buxheti i planifikuar për këtë aktivitet është ndarë sipas strukturës së re institucionale.

Duke u bazuar në këto rrethana dhe në pamundësinë për të siguruar financimin e kontratës, Autoriteti Kontraktues anulon procedurën e prokurimit, për shkak të mungesës së mjeteve buxhetore të nevojshme për realizimin e saj.

Ky anulim bëhet në përputhje me dispozitat përkatëse të Ligjit për Prokurimin Publik, që lejojnë anulimin e procedurës në rastet kur Autoriteti Kontraktues nuk ka më mjete të mjaftueshme buxhetore për realizimin e kontratës.

02-2-2026

Në bazë të arsyeve të dhëna nga AK, lidhur me ndarjen e ministrive sipas vendimit të Qeverisë me numër 02/02 të datës :20.02.2026, ku sqaron se me këtë vendim ka ndarje të ministrive dhe riorganizim institucional duke theksuar se është bërë edhe ndarja e buxhetit.

Ndryshimi/ndarja e ministrive është fakt dhe ngjarje juridike reale e cila ka ndodhur me vendimin e Qeverisë numër: 02/02 i datës 20.02.2026.

Sqaroj se jo-domosdoshmërishtë duhet apo do të ndikojë ndarja e ministrive në procedura administrative-procudurale të cilat pavarësishtë ndarjeve ato prap se prap i kanë apo formojnë organet të cilat kanë përgjegjësi të caktura për funksionimin dhe realizimin si në rastin konkret për zbatimin e

procedurës së prokurimit.

Mirëpo pasi që me vendimin e Qeverisë numër 02/02 i datës 20.02.2026, ka ndodhur ndarje të Ministrive, riorganizim institucional dhe ndarje buxhetore, konsideroj se arsyetimi i AK është objektiv me rrethanen juridike të re e cila është krijuar me rastin e vendimit të Qeverisë.

REKOMANDIMI I EKSPERTIT SHQYRTUES

Duke u bazuar në sqarimet e lartpërmendura, eksperti shqyrtues i propozon panelit shqyrtues që ankesa e OE ankues refuzohet si e pabazuar dhe të mbetet në fuqi vendimi i AK.

Raporti i ekspertit shqyrtues, lidhur me ankesën e parashtruar nga OE “**Inspired Tech SH.P.K.**”, lidhur me aktivitetin e prokurimit “**Mirëmbajta e platformës elektronike për monitorimin e reformës në Administratë Publike**” me numër të prokurimit: “**214-25-7856-2-2-1**”, të iniciuar nga Autoriteti Kontraktues (AK) – **MINISTRIA E PUNËVE TË BRENDSHME**

Raporti i ekspertizës ti dorëzohet:

- Autoritetit Kontraktues – **MINISTRIA E PUNËVE TË BRENDSHME**
- Panelit Shqyrtues – **OSHP**
- OE ankues – **Inspired Tech SH.P.K.**

Kushtrim Myftari

